



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA THEMELORE E GJILANIT**  
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN

---

Në bazë të Nenit 4 të Rregullores për Procedurën e Rekrutimit të Praktikantëve në **Gjykatën Themelore në Gjilan –Degët e saj**, për praktikant vullnetarë (pa Pagesë), për kohë të caktuar, në kohëzgjatje prej një viti: **Rishpall**

**K O N K U R S**

**Nr.2/2024**

Për praktikantë vullnetarë:

1. **Gjykata Themelore Gjilan—Dega Novobërdë-----5 praktikantë**

**Përshkrimi i detyrave të punës**

**Titulli i pozitës: Praktikantë**

**Nëpunësi mbikëqyrës:** Vepron nën mbikëqyrjen e drejteperdrejt të nd. Administratorit të Gjykatës.

**Detyrat dhe Përgjegjesit:**

- 1.Ndihmon gjyqtaret për përgatitjen e lendeve për seanca degjimore dhe veprime tjera
2. Ndihmon në hulumtime për hartimin dhe përgatitjen e memorandumeve të politikave dhe memorandumeve ligjore
- 3.Ndihmon në hartimin dhe përgatitjen e draft vendimeve opinioneve dhe pune të tjera brenda zyrës

**Kualifikimet:**

~ Diploma e Fakultetit Juridik ;

- ~ Njohuri të procedurave gjyqësore;
- ~ Aftësi për kryerjen e hulumtimeve gjyqësore (juridike);
- ~ Njohuri të mjaftueshme ligjore;
- ~ Aftësi të shkëlqyeshme në përpilimin me shkrim të drafteve juridike, duke përfshirë aftësinë në përpilimin e dokumenteve ligjore, si dhe shkathtësi komunikimi në të folur.

## **Deshmit:**

- ~ Kopjen e leternjoftimit;
- ~ Certificate qe nuk eshte duke u zhvilluar procedure penale;

## **VËREJTJE:**

- Procedura e konkursit është hapur për kandidatët të jashtëm dhe nëpunësit civil ekzistues.
- Procedura e rekrutimit zhvillohet sipas procedurave të parapara me Ligjin mbi shërbimin civil Nr.03/L-149 dhe Rregullore, Nr.02/2010 për procedurat e rekrutimit të shërbimit civil.
- Konkursi është publikuar më **dt.21.03.2024 deri më dt.04.04.2024**

Aplikacionet mund t'i merrni dhe t'i dorëzoni në Gjykatën Themelore në Gjilan , Rr. Maria Shllaku Pn. në Gjilan në Zyrën e Pranimit dhe në Gjykatë dhe në degët e Gjykates

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

- Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në Nenin 11,pragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Aplikacioni pas skadimit të afatit të konkursit nuk pranohen. Për shkak të numrit të madhe të kërkesave të pranuar vetëm kandidatët e përzgjedhure në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë banorët e Kosovës prej moshës 18-64 vjeçare. Aplikacionet duhet të plotësohen qartë dhe lexueshëm. Në aplikacion duhet të shënohen të gjitha të dhënat e kërkuara. Duhet të përcaktohet saktësisht vendi ku konkurron. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten dokumentet e nevojshme për konkurrim, siç janë: kopja e diplomës për shkollën e kryer, specializimet e ndryshme profesionale, certifikata të tjera, dy rekomandime etj.

**Nëse aplikacionit nuk ia bashkëngjitni dokumentet e duhura dhe nuk e plotësoni atë me shënime të sakta, ju vetë do ta humbni rastin për t'u futur në listën e ngushtë.**

- Fotokopjet e dokumenteve të bashkangjitura në aplikacion kandidatët nuk kanë të drejtë ti tërheqin prapa.
- Në rast të ndonjë pyetje apo paqartësi mund të kontaktoni zyrtare i/e personelit

[Shkarko Aplikacionin](#)